



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5017 Prot.

Tiranë, më 27. 7. 2022

U D H Ë Z I M

Nr. 21, datë 27. 7. 2022

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E
MEDALJES SË ARTË NXËNËSVE TË SHKËLQYER NË VITE, PAS
PËRFUNDIMIT TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

KREU 1

KRITERET PËR PËRFITIMIN E MEDALJES SË ARTË

1. Nxënësit të shkëlqyer ndër vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, i jepet “Medalje e artë”, nëse plotëson njëherësh kriteret e mëposhtme:
 - a) Ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00.
 - b) Në të gjitha provimet e Maturës Shtetërore (të detyruara dhe me zgjedhje) është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.50, nga të cilat të paktën në një provim të Maturës Shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 10.00.
 - c) Ka vlerësimin në sjellje “Shumë mirë”, në gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë.
2. Nderohet me “Medalje e artë” nxënësi që është fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, sipas procedurave të Rregullores “Për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrja e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare”.

KREU 2

PROCEDURA PËR DHËNIEN E “MEDALJES SË ARTË”

1. Në javën e parë të vitit shkollor, Qendra e Shërbimeve Arsimore (QShA) dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) listën emërore të nxënësve që plotësojnë kriteret sipas shkronjave a dhe b, të pikës 1, të kreut 1, të udhëzimit. DPAP e përcjell këtë listë nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë parauniversitar (IAP).
2. Në javën e dytë të vitit shkollor institucionet e arsimit të mesëm të lartë, përgatisin dhe dërgojnë në ZVAP, listat dhe dosjet e nxënësve që plotësojnë kriteret për “Medalje e artë” sipas kreut 1 të këtij udhëzimi.
3. Dosja e nxënësit përmban dokumentet e mëposhtme:
 - a) fotokopjen e kartës së identitetit;
 - b) fotokopjen e diplomës dhe certifikatës së Maturës Shtetërore;
 - c) vlerësimin për sjelljen, për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë, lëshuar nga drejtorja e shkollës;
 - d) fotokopjen e certifikatës që nxënësi ka fituar në olimpiadën ndërkombëtare, sipas pikës 2, të kreut 1, të këtij udhëzimi, nëse ai e disponon.
4. ZVAP-et përcjellin listat dhe dosjet e nxënësve në DRAP-et dhe këto të fundit i përcjellin në DPAP.
5. Në javën e tretë të vitit shkollor DPAP përcjell në QShA listën emërore të nxënësve të shoqëruar me certifikatën përkatëse që nxënësi ka fituar në olimpiadën ndërkombëtare, sipas kriteve të pikës 2, të kreut 1, të këtij udhëzimi. QShA pasi kryen verifikimet e përcjell atë në DPAP.
6. Në javën e katërt të vitit shkollor DPAP, përcjell në MAS, listën emërore të nxënësve të verifikuar nga QShA së bashku me dosjet e nxënësve që përfitojnë “Medaljen e artë”.
7. MAS pasi kryen verifikimin përfundimtar të dosjes për secilin nxënë, sipas kriteve dhe procedurave të këtij udhëzimi, përcjell në Kryeministri listën e nxënësve që u jepet “Medalje e artë”, të shoqëruar me projekt urdhrin dhe relacionin shoqërues.

KREU 3

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. MAS ka detyrimin të prodhojë “Medalje e artë” për të gjithë nxënësit që i përfitojnë ato.
2. MAS mban në një regjistër të veçantë të dhënat e nxënësve, të cilët janë pajisur me medaljen e artë.

3. Udhëzimi nr. 8, datë 08.04.2021, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e Medaljes së artë”, i ndryshuar, shfuqizohet.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të mesëm të lartë parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Evis KUSHI

